



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosovo
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 17 shkronja h, nenin 62 paragrafin 62.3, të Ligjit nr.03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 81 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.-I-34, datë 25.04.2020, nenet 6 dhe 19 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave, Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollor, Nr.-I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.-X-617 të datës 09.09.2022, Drejtoria e Arsimit më 09.09.2022 shpall:

KONKURS

(Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës për vitin shkollor 2022-2023)

Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të Komunës së Obiliqit të katër kategorive:

- 1.Për nxënës nëse distanca e udhëtimit shtëpi –shkollë është së paku 3 kilometra
- 2.Për nxënës me nevoja të veçanta
3. Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në qoftë se në relacionet e udhëtimit të katër nxënësve është i organizuar udhëtimi publik apo privat.
- 4.Për nxënës të Komunës së Obiliqit në shkollat e mesme të larta,që vazhdojnë shkollimin në komunat tjera,por vetëm në drejtimet që nuk janë në shkollat e mesme të larta në Komunën e Obiliqit.

Dokumentet e nevojshme për të gjitha kategoritë :

- Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i rregullt dhe për distancën shtëpi-shkollë
- Kopja e letërnjoftimi (në mungesë të letërnjoftimit të sjell certifikatën e lindjes),
- Për rastet nxënës me nevoja të veçanta, të sjellin edhe diagnozën e mjekut
- Për rastet sociale, të sjellin edhe vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq.
- Konfirmimin banker i nxënësit ose prindërit
- Letërnjoftimi i nxënësit ose prindërit

Sqarim:Letërnjoftimi dhe konfirmimi banker duhet të jenë vetëm të njërit prind

Komisioni për ndarjen e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit e ruan të drejtën, të verifikojë gjendjen faktike të kriterëve të kërkuara sipas konkursit për kandidatët që kanë aplikuar për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit .

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së ,ose në faqe zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë pune.

Drejtori :Sahit Zeqiri

